Nr. 1536 Prot
Dt. 30.04.2026

Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut

Dega Devoll

Nr. 8 Prot. Datë 8 / 04 / 20226

Lënda: Kërkesë për ngritje lapidari

Drejtuar: Kryetarit të Bashkisë z. Eduard Duro

Këshillit Bashkiak

DEVOLL

I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë të këshillit bashkiak,

Organizata Kombëtare e Dëshmorëve të LANÇ dhe Dëshmorëve të tjerë të Atdheut, dega Bilisht e ka vlerësuar gjithmonë përkrahjen dhe ndihmën Tuaj të dhënë në vijimësi ndaj kësaj organizate. Tek ju kemi gjetur mbështetje dhe realizim të misionit për vijimin e përkujtimit dhe të nderimit të Dëshmorit të Atdheut.

Në bazë të Ligjit Nr. 109/2018, "Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut", në Neni 15, Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut, pika 1. Në shenjë nderimi për dëshmorët e atdheut, me vendim të këshillit të qarkut/këshillit bashkiak/prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen, sipas përgjegjësisë përkatëse lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore si dhe emërtohen mjedise e institucione publike, si dhe të LIGJ Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni Neni 25, Funksionet e bashkive në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Në lidhje më këto ligje, kemi bërë **kërkesën** për ngritjen e lapidarit për arsye se mungon një objekt ku të gjithë përfaqësuesit e familjeve të dëshmorëve të kryejnë homazhe në shenjë respekti ndaj 208 dëshmorëve të rënë në LANÇ .

Falënderime për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin!

Kryetar i Organizatës së Dëshmorëve

Arti Muçka